

Tanush Shaska ka i ka paraqitur Ministrat të Arsimit Myqerem Tafaj dorëheqjen nga posti i Rektorit të Universitetit të Vlorës, post që e mbante prej vitesh.



Sipas Shaskës, institucioni që ai drejtonte është vënë prej kohësh nën presion nga organe të gjykatës, prokurorisë për të ndihmuar djalin e një gjykatësi të merren parasysh provimet e dhëna në një shkollë private të panjohur nga MASH.

Ish-rektori akuzon [kryeministrin Berisha](#) dhe ministrin Tafaj se ata shkatërrojnë sistemin arsimor.

Menjëherë ka reaguar [Këshilli i Ministrave.org](#) ku me anë të një deklaratë sqaron se kurrsesi Kryeministri nuk mund të ketë si qëllim të shkatërrojë arsimin por vetëm Piramidën.

Sipas verifikimeve, Universiteti i Vlorës nuk ka formë Piramide dhe në të nuk janë shpenzuar miliona euro për ta bërë teatër ndaj akuza të tillë nga z.Tanush janë të pabaza.

[Kryeministri Berisha](#) deklaroi se duke dhënë dorëheqjen, Shaska vërtetoi se është i majtë pasi një demokrat i vërtetë nuk heq dorë nga posti, edhe sikur të përbyset bota, sikur të hapen digat, e të shpërthejnë qindra Gërdecë.

[Këshilli i Ministrave.org](#) do të dëshironte të distancohej nga kjo ngjarje, por nuk ka nevojë mqs Vlora është vetë në distancë të largët nga kryeministri Berisha.

